REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

SHTATOR - SE

TIRANE, 200

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE.

Ministria e Financave

Drejtoria e Makroekonomisë

Raporti Mujor

Shtator 2003

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....8
   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....9
   c. SEKTORI I JASHTËM.....10
   d. SEKTORI MONETAR.....11

3. TABELAT MBËSHTETËSE
   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Norma e interesit
   d. Buxheti i konsoliduar
   e. Shpenzimet institucionale
   f. Shpenzimet sipas funksionit
   g. Investimet
   h. Të ardhurat sipas burimeve
   i. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   j. Financimi i defiçitit
   k. Bilanci i pagesave
   l. Mjete valutore neto
   m. Krediti i brendshëm
   n. Oferta e parasë
   o. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE

Indeksi i cmimeve te konsumit, ne muajin Shtator 2003, arriti ne 101.29 perqind, duke u rritur me rreth 0.7 përqind, pas rritjes me rreth 0.2 përqind në Gusht dhe renies me rreth 0.4 përqind në Korrik. Indeksi i cmimeve te konsumit ne kete muaj ishte rreth 0.4 per qind me i ulet se gjate muajit Dhjetor 2002.

Kursi mesatar i kembimit per muajin Shtator 2003, ishte:

- 120.62 leke per US dollar
- 135.32 leke per Euro



Kjo reflekton zhvleresim te monedhes shqiptare, lekut, kundrej dollarit amerikan me rreth 0.6 perqind dhe Euros, me rreth 1.2 perqind, ne muajin Shtator krahasuar me muajin paraardhes.

Normat e interesit te depozitave vazhduan trendin e tyre rënes. Norma e interesit per depozita me afat 12 mujor ra nga 8.3 në 7.9 përqind, nderkohe qe



ajo per depozita me afat 6 mujor u ul nga 7.8 ne 7.6 perqind, gjatë muajit korrik.



Te ardhurat e mbledhura deri ne fund te muajit Shtator arriten ne rreth 119.48 miliarde leke ose rreth 68 perqind e programit vjetor 2003.
Shpenzimet buxhetore , arriten ne rreth 139,9 miliarde leke, ose rreth 63 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2003.

Si rrjedhim **deficiti i pergjithshem** ishte rreth 20,46 miliarde leke, ose rreth 43 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2003.



Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 63 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 119,8 miliardë lekë ose rreth 71 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit dhe te shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes (perkatesisht 83 përqind dhe 78 përqind e buxhetit vjetor).

Të ardhurat gjithsej arritën në rreth 68 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 68 përqind të programimit vjetor
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 69 përqind
- Të ardhurat jo-tatimore 59 përqind e buxhetit vjetor
- Të ardhurat nga pushteti lokal 86 përqind e planifikimit vjetor

Bilanci i pagesave per muajin Qershor 2003 rezultoi me nje defiçit te pergjithshem prej 0.5 milion $.
Kjo ishte rezultat i:

- nje defiçiti te Llogarise Korente, prej 46.8 milion $
- nje suficit te Llogarise se Kapitalit, prej 13.7 milion $
- nje defiçiti te Llogarise Financiare, prej 14.6 milion $
- nje bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 47.1 milion $



Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 46.8 milion $ ishin:

- nje bilanc tregtar negativ prej 124 milion $
- nje suficit prej 8.4 milion $ ne bilancin e sherbimeve
- nje suficit prej 13.7 milion $ ne bilancin e te ardhurave
- nje suficit prej 55.2 milion $ ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet



Në baze kumulative, në fund të Qershorit 2003 bilanci i pagesave rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 61.2 milionë $.

Komponentët kyç ishin:

- defiçiti prej 208.9 milionë $, në llogarinë korrente
- sufiçiti prej 67.5 milionë $ ne llogarine kapitale
- suficiti prej 82 milionë $ në llogarinë financiare
- bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej 120.7 milionë $

Oferta totale e parasë, e matur nga M3 arriti në 432.5 miliardë lekë në fund të muajit Korrik, duke shenuar një rritje prej 9 përqind ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



Rritja u reflektua në rritjen e depozitave me afat ne leke, me rreth 25 perqind, dhe rënien e parasë në qarkullim me rreth 10 përqind krahasuar me një vit më parë.



2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. INDEKSI I ÇMIMEVE TE KONSUMIT DHE TREGUES TË TJERË

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i cmimeve te konsumit vazhdoi te rritet me 0.7 përqind në Shtator, pas rritjes prej 0.2 përqind në Gusht dhe renies prej 0.4 përqind në muajin Korrik. Ndryshimet mujore koresponduese te një viti më parë ishin respektivisht 0.9 përqind, 0.2 përqind, dhe -0.7 përqind. Rritja e ndeksit te cmimeve te konsumit ne muajin Shtator 2003 me rreth 0.7 perqind eshte kryesisht rezultat i rritjes se indeksit te cmimeve te grupit "Hotele, kafene dhe restorante" prej rreth 2 perqind si dhe e grupit "Ushqime dhe pije joalkolike prej rreth 1.6 perqind.
Ne muajin shtator 2003 norma vjetore e inflacionit ishte 2.7 perqind, nderkohe qe nje muaj me pare kjo norme arriti ne rreth 5.3 perqind.
E llogaritur si mesatare mujore, norma e inflacionit per 9 mujorin, janar-shtator arriti ne rreth 2.1 perqind.
Ndryshimet vjetore te indeksit te cmimeve te konsumit ne perqindje per vitet 2002 dhe 2003 paraqiten ne tabelen e meposhtme:

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nen	Dhj.
2002	6.5	7.6	7.5	6.5	4.6	3.7	4.2	5.5	5.3	5.8	3.7	1.7
2003	0.0	1.1	1.4	2.3	2.8	2.6	3.0	3.0	2.7			

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit te lekut me dollarin pesoi nje rritje te lehte gjate muajit Shtator 2003, pas një renie të lehtë në muajin Gusht. Megjithate, në fund të muajit, arriti ne 118.1 lekë, krahasuar me mesataren mujore prej 120.62 lekë.

Euro u rrit në një mesatare prej 135.32 lekë në Shtator, krahasuar me 133.66 lekë në muajin Gusht. Në fund të muajit Shtator , Euro u këmbye me 137.91 lekë.

Gjate muajit shtator 2003, krahasuar me nje vit me pare, dollari amerikan ka humbur rreth 18.7 Leke per USD, ose eshte zhvleresuar me rreth 13.4 per qind, kurse monedha europiane megjithese eshte shfaqur me e qendrueshme ne sjelljen e saj ne krahasim me USD, perseri edhe ajo eshte zhvleresuar ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar, me rreth 1 per qind.



Norma e Interesit

Shkalla e depozitave mesatare 12 mujore u ul nga 10.2 përqind, në 10.1 përqind, ne Shtatorit 2003;

Interesi i huave 12 mujore mbeti i njëjtë prej 12.2 përqind në Qershor dhe korrik; interesi i huave 6 mujore, u ul nga 14.3 përqind gjatë Qershorit ne 13.6 perqind gjate muajit korrik;

Interesat e Bonove të Thesarit 12 mujore u ulën nga 11.4 përqind në 10.2 përqind.

b. SEKTORI FISKAL

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Shtator 2003, u mblodhen rreth 119,5 miliarde leke te ardhura gjithsej, nderkohe qe shpenzimet e pergjithshme arriten ne rreth 139,9 miliarde leke, dhe perfshinin 119,8 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 20,2 miliard lek shpenzime kapitale. Si rrjedhim, deficiti arriti ne nivelin 20,5 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben 68% te te ardhurave buxhetore per vitin 2003, ndersa shpenzimet perbejne 63% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane 71% e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane 41%.

Nga te ardhurat gjithsej, te ardhurat e mbledhura nga Drejtorite e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave arriten ne 78,6 miliarde leke (68% e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 6,9 miliarde leke (86% e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 21,1 miliarde leke (69% e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore arriten ne 12,8 miliarde leke (59% e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 119,8 miliarde leke, 30,8 miliarde leke (26%) eshte shpenzuar per personelin, 22,5 miliarde leke (19%) per interesat, 15,4 miliarde leke (13%) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 2,8 miliarde leke (2%) per subvencione dhe 32,4 miliarde leke (27%) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore.

Keto perfaqesojne 66% (personeli), 83% (interesat), 78% (shpenzime operative dhe mirembajtje), 45% (subvencione), 72% (sigurimet shoqerore), 69% (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) te buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne 20,2 miliarde leke, nga te cilat 58% financim i brendshem, dhe 42% financim i huaj. Investimet me financim të brendshëm ishin 11.7 miliardë lekë, nga të cilat 7 miliardë nga pushteti qendror, dhe 4.7 miliardë nga pushteti lokal.
Financimi i brendshem llogaritet per kete periudhe ne rreth 55% te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 30%.

Deficiti prej 20,5 miliarde leke eshte i barabarte me 43% te deficitit buxhetor per vitin 2003.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik
Te ardhurat gjithsej arriten në fund të Shtatorit 2003 ne rreth 119.5 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 85.5 miliardë, dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 12.8 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, 40.2 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave, 41 miliardë lekë nga ajo e tatimeve, dhe 4.3 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Shtator:

p.	TVSH përbënte	36.1 miliardë lekë
q.	Tatimi mbi fitimin	9.7 miliardë lekë
r.	Taksa doganore	10.0 miliardë lekë
s.	Taksat nacionale	9.2 miliardë lekë
t.	Akcizat	9.0 miliardë lekë
u.	Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	6.3 miliardë lekë;

Taksat e mallrave dhe te shërbimeve vazhduan te jenë burimet më të rëndësishme të të ardhurave tatimore, duke përbërë 65.3 përqind të tyre deri në fund të Shtatorit 2003, nderkohe qe tatimi mbi fitimin dhe të ardhurat zuri rreth 14.4 përqind dhe tatime mbi tregtine rreth 11.7 përqind.

Financimi i Defiçitit
Defiçiti prej 20.5 miliardë lekë, ne fund te shtatorit 2003, ishte 67 përqind me financim të brendshëm dhe 33 përqind me financim të huaj. Nxjerrja e bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa huatë afat gjata, për financimin e huaj.

c. SEKTORI I JASHTËM

Bilanci i Pagesave
Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për muajin Qershor ishin:

Nje deficit i pergjithshem prej 0.5 milion $. Kjo ishte rezultat i nje:

v. defiçiti te Llogarise Korente, prej 46.8 milion $
w. suficit te Llogarise Kapitale, prej 13.7 milion $
x. defiçiti te Llogarise Financiare, prej 14.6 milion $
y. bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 47.1 milion $

Asetet rezervë u rrit me 0.5 $ milionë;

Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 46.8 milion $ ishin:

- nje bilanc tregtar negativ prej 124.1 milion $;
- nje suficit prej 8.4 milion $ ne bilancin e sherbimeve ;
- nje suficit prej 13.7 milion $ ne bilancin e te ardhurave ;
- nje suficit prej 55.2 milion $ ne levizjet e transfertave dhe dergesave .

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe flukset negative ne llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investimeve direkte prej $14.2 milionë,
- flukset pozitive të investimeve në investimet fizike prej $7.2 milionë
- flukset negative të kapitaleve të tjera prej $35.9 milionë.

Në baze kumulative kishte një sufiçit të përgjithshëm në bilancin e pagesave, prej 61.2 milionë $, në fund të Qershorit 2003.
Komponentët kyç ishin:

- defiçiti prej $208.9 milionë në llogarinë korrente,
- sufiçiti prej $67.5 milionë ne llogarine kapitale
- suficiti prej $82 milionë në llogarinë financiare,
- bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej $120.7 milionë.

d. SEKTORI MONETAR

Mjete Valutore Neto
Pas rritjes në Qershor, mjetet valutore neto u ulen me 4.1 milionë dollarë në muajin Korrik, si rezultat i rritjes së aseteve me 0.9 milionë dollarë dhe rritjes se detyrimeve me 3.2 milionë dollarë.

Krediti i Brendshëm
Gjatë muajit Korrik 2003, krediti total në ekonomi (përjashto BART) u rrit nga 44.5 miliardë lekë në 46.7 miliardë lekë, me një rritje prej 4.9 përqind;
Borxhi i familjarëve u rrit nga 9.2 miliardë lekë në 10 miliardë lekë, ose një rritje prej 8.7 përqind.
Borxhi për pjesën tjetër të sektorit privat u rrit nga 35.3 miliardë lekë në 36.7 miliardë lekë, ose një rritje prej 4 përqind.

Oferta e Parasë
Oferta e parasë (e matur me M3), paraja totale jashtë bankave, depozitat pa afat, dhe depozitat me afat në monedha të huaja dhe lekë) u arriti ne 432.5 miliardë lekë në fund të Korrikut, ose me një rritje prej 9 përqind kundrejt një viti më parë.

Rritja u reflektua në rritjen prej 25 perqind te depozitave me afat, ne rënien e parasë në qarkullim prej 10 përqind krahasuar me një vit më parë.

Depozitat sipas Burimeve
Kjo tabelë tregon përbërjen e depozitave që kontribuojnë në përkufizimet e ndryshme të ofertës së parasë (Tabela 14) sipas llojit të depozitorëve.

Një ekzaminim i tabelës tregon se në muajin Korrik 2003:

- Sektori privat ishte burimi më i rëndësishëm i depozitave pa afat, ndjekur nga ndërmarrjet publike jo-financiare
- Sektori privat ishte gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedha të huaja, në një nivel prej 18.5 përqind mbi familjarët
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (me 97 përqind të totalit) dhe depozitave me afat në monedha të huaja (me 90 përqind të totalit)
- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (83.4 përqind) të depozitave totale prej 312 miliardë lekë. Ata ndiqen nga sektori privat (10.5 përqind), ndërmarrjet publike jo-financiare (5.1 përqind), dhe autoritetet lokale (1 përqind)
- Institucionet financiare kontribuan me 0.1 përqind të depozitave totale

Gjatë Korrikut niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 3.9 miliardë lekë, nga ku rritja e depozitave me afat në lekë, ishte rreth 1.6 miliardë lekë, rritja e depozitave me afat, ne valute, 1.6 miliarde leke , rritja e depozitave pa afat ne valute, 1.1 miliarde leke dhe ulja e depozitave pa afat ne leke, te cilat u ulen me 0.5 miliarde leke.

Depozitat me afat, të sektorit privat, në lekë mbeten pothuajse ne te njejtin nivel, me nje rritje shume te lehte.
Depozitat me afat ne valute te familjareve u rriten, gjate muajit Korrik 2003, me 1.4 miliarde leke.